

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit Sokol Berberi.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të Ligjit nr. 8577/2000.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe z.Dedë Kasneci.

4. Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 229, pika 1 e nenit 234, 235, 236, 237, 239 e 240 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.

5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, relatore për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, znj. Arta Marku.

7. Z.Dedë Kasneci, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Dedë Kasneci, gjendet e administruar në dosjen e kandidatit.

8. Në datën 09.04.2019, kandidati Dedë Kasneci është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidatit.

9. Në datën 15.04.2019, kandidati Dedë Kasneci ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidatit.

10. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr. 265 prot, datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr. 115/2016.

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Dedë Kasneci, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

12. Me shkresën nr. 2854/4 prot, datë 03.05.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidati Dedë Kasneci e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

13. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, të Ligjit nr. 9049/2003 dhe Ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr.14/28 prot., datë 29.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Dedë Kasneci dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të pikës 4 të nenit 229 dhe nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit Dedë Kasneci dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatit Dedë Kasneci, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 17.04.2019, i është drejtuar me

kërkesa për informacion institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidatës), si më poshtë:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka Intesa Sanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka Societe Generale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.
- b) Institucioneve financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring & Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekteve financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit ËVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidatin Dedë Kasneci.

17. Në lidhje me rezultatet e kontrollit të ushtruar dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI, në datën 29.05.2019, Këshilli ka njoftuar në rrugë elektronike kandidatin Dedë Kasneci për të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje, si edhe të depozitohet çdo dokument justifikues që vlerëson të paraqesë në mbështetje të shpjegimeve të tij.

18. Kandidati Dedë Kasneci, pasi i është pranuar kërkesa për më shumë kohë për paraqitjen e shpjegimeve, në datën 06.06.2019, ka depozituar pranë Këshillit shpjegimet përkatëse duke bashkëlidhur edhe dokumentacion shtesë justifikues.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 110 prot., datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati Dedë Kasneci sipas Ligjit nr. 138/2015.

20. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1134/131 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Dedë Kasneci.

21. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit Dedë Kasneci, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (shkresa nr. 120 prot., datë 17.04.2019), Shërbimit Informativ të Shtetit (shkresa nr. 114 prot., datë 17.04.2019), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (shkresa nr. 118 prot., datë 17.04.2019) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (shkresa nr. 117 prot., datë 17.04.2019).

22. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vijim të procedurës së sipërcituar për verifikimin e integritetit, me shkresën nr.352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar të kërkuar pranë institucioneve përkatëse ligjzbatuese për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve.

23. Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat nr.1545 prot., datë 10.06.2019 dhe nr.680/1 prot., datë 15.05.2019, mbi të dhënat e kërkuara për të gjithë kandidatët, përfshirë edhe kandidatin Dedë Kasneci.

24. Në vijim të procedurave të verifikimit dhe kontrollit të integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr.112 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nr. 45/2015 nga kandidati Dedë Kasneci për kompetencë dhe shqyrtim pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

25. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 551/1 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar vendimin nr. 271 datë 02.05.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Dedë Kasneci.

26. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidati Dedë Kasneci në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

27. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, Këshilli në datën 02.05.2019 i është drejtuar me kërkesë për informacion partive politike, si dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (shkresa nr. 270 prot., datë 19.04.2019), duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Në përgjigje të këtyre kërkesave, KQZ dhe parti politike kanë

dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidatin Dedë Kasneci.

28. Në zbatim të pikës 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000, nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 08.07.2019, Këshilli i ka kërkuar kandidatin Dedë Kasneci të paraqesë shpjegime me shkrim lidhur me veprimtarinë e tij profesionale në kuptim të përmbushjes së kushteve të kandidimit të caktuara nga dispozitat ligjore të sipërcituara, më konkretisht për periudhat e vjetërsisë në punë me statusin asistent pedagog, si edhe inspektor jurist pranë Prefektit të Qarkut Shkodër.

29. Në datën 11.07.2019, kandidati Dedë Kasneci ka paraqitur pranë Këshillit shpjegime me shkrim duke dhënë sqarime se kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar e ka depozituar pranë Presidentit të Republikës me datë 22.02.2018 dhe kërkesën e dytë me datë 15.03.2018 së bashku me dokumentacionin shtesë mbështetës që sipas tij tregojnë përmbushjen e kushtit ligjor të vjetërsisë në punë.

30. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75, 87 dhe 94 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", duke vlerësuar paraprakisht se ka të dhëna dhe gjetje që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, anëtarja raportore e Këshillit znj. Arta Marku ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

31. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 17.07.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të z.Dedë Kasneci, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

32. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatin Dedë Kasneci.

33. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

34. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 17.07.2019, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

35. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

36. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit Dedë Kasneci.

37. Në thelb, Avokati i Popullit, krahas qëndrimit të përgjithshëm se edhe për këtë rast nuk ka pasur nga KED në dispozicion dokumentacionin e plotë ku bashkëlidhur akteve të procedurës së verifikimit mungojnë edhe një pjesë dokumenteve dhe përgjigjeve të sjella nga institucionet, parashtroi se:

- ka mungesë dokumentacioni në dosjen e dërguar pranë Avokatit të Popullit që vërteton plotësimin e kriterëve dhe kushteve të tjera ligjore, mbi bazën e të cilave mund të jepen konkluzione paraprake mbi procedurën e ndjekur, veçanërisht lidhur me arsimin, përvojën etj.
- rekomandohet të verifikohet gjendja penale për periudhën gjatë së cilës ka jetuar jashtë shtetit (rreth 5 vjet)
- të shikohet me kujdes çështja e vjetërsisë dhe përvojës në punë, si edhe pozicioni i punës në përmbushje të kriterëve të përcaktuara për kandidatët për anëtar të Gjykatës Kushtetuese.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

38. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatit Dedë Kasneci për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

39. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

40. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”

41. Kushtet e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, sikurse janë edhe ato të përmendura në pikat 39 dhe 40 më sipër, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për tu përzgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga organi i emërtesës.

42. Për rrjedhojë, nëse kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të vënë në bisedim dhe për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

43. Nisur nga të dhënat dhe gjetjet që rezultojnë nga procedura e verifikimit për kandidatin Dedë Kasneci, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerësoi të bisedojë dhe të konkludojë pikësëpari në lidhje me plotësimin ose jo të kushtit ligjor të parashikuar nga neni 125 pika 4 e Kushtetutës dhe neni 7/a pika 2 e Ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike.

44. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë *të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidati Dedë Kasneci ka ushtruar veprimtari profesionale si:

a) Lektor për lëndët “E drejta Agrare”, “E drejta administrative”, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë, për periudhën Shkurt 1999 – Mars 2000;

b) Inspektor jurist, pranë Prefektit të Qarkut Shkodër, për periudhën Mars 2001 – Prill 2003;

c) Këshilltar ligjor në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit, pranë Kuvendit të Shqipërisë, për periudhën Prill 2007 – Prill 2010;

ç) Drejtor i Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit, pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në periudhën prill 2010 edhe në vazhdim.

d) Lektor i jashtëm i lëndës “E drejta institucionale e Bashkimit Europian”, pranë Universitetit “Gjon Buzuku” Shkodër, Fakulteti i Drejtësisë, për periudhën Mars 2011 – Korrik 2014;

45. Nisur nga këto të dhëna të jetës profesionale, duke pasur parasysh përcaktimet e pikës 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000, nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 08.07.2019, Këshilli i ka kërkuar kandidatit Dedë Kasneci të paraqesë shpjegime me shkrim lidhur me veprimtarinë e tij profesionale në kuptim të përmbushjes së kushteve të kandidimit të caktuara nga dispozitat ligjore të sipërcituara, më konkretisht për periudhat e vjetërsisë në punë me statusin asistent pedagog, si edhe inspektor jurist pranë Prefektit të Qarkut Shkodër.

46. Në datën 11.07.2019, kandidati Dedë Kasneci ka paraqitur pranë Këshillit shpjegime me shkrim duke dhënë sqarime se kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar e ka depozituar pranë Presidentit të Republikës me datë 22.02.2018 dhe kërkesën e dytë me datë 15.03.2018 së bashku me dokumentacionin shtesë mbështetës që sipas tij tregojnë përmbushjen e kushtit ligjor të vjetërsisë në punë. Në thelb, kandidati Dedë Kasneci shpjegon se deri në datat e kandidimit të tij ka në veprimtarinë e tij profesionale :

- 1 vit e një muaj vjetërsi pranë Universitetit të Shkodrës, në Fakultetin e Drejtësisë, si lektor i lëndës “*E Drejta Agrare*” dhe “*E Drejta Administrative*”, në periudhën Shkurt 1999 – mars 2000;
- 2 vjet e 1 muaj vjetërsi si inspektor jurist pranë Prefektit të Qarkut Shkodër, në periudhën mars 2001 – prill 2003;
- 3 vite e 4 muaj vjetërsi si lektor i lëndës “*E drejta institucionale e Bashkimit Europian*” pranë Universitetit “Gjon Buzuku” Shkodër, për periudhën mars 2011 – korrik 2014;
- 3 vjet e 4 muaj vjetërsi si këshilltar ligjor në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për periudhën prill 2007 – prill 2010;
- 7 vite e 10 muaj deri në datë 22.02.2018 dhe 7 vite e 11 muaj deri në datën 15.03.2018 vjetërsi si Drejtor i Përafrimit të Legjislacionit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, për periudhën prill 2010 – dhe deri në ditët e depozitimit të kërkesës për kandidim për secilin nga vendet vakante.

47. Për rrjedhojë, bazuar në këto të dhëna, kandidati Dedë Kasneci parashtroi se ka gjithsej *17 vite 4 muaj* veprimtari profesionale për vendet vakante të shpallura nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe *17 vite e 5 muaj* veprimtari profesionale për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018. Kandidati ka parashtuar se nuk ka periudha të tjera punësimi përveç atyre të treguara në pikën 44 dhe 46 të këtij Vendimi. Gjithashtu, shpjegon se gjatë kohës kur ka qenë jurist inspektor pranë Prefektit Shkodër statusi i vendit të punës ka qenë rregulluar me Kodin e Punës. Ai sqaron se ka qenë lektor i jashtëm, në këtë pozicion pune është pranuar me konkurs publik dhe se, sipas nenit 4 të Ligjit nr. 80/2015, rezulton se lektori është një ndër kategoritë e personelit akademik të një universiteti.

48. Në pikën 4 të nenit 125 të Kushtetutës përcaktohet se: “*Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.*”.

49. Në kuptim dhe zbatim të drejtë të këtyre dispozitave kushtetuese dhe ligjore, nisur nga të dhënat mbi kohëzgjatjen dhe llojin e veprimtarisë profesionale të ushtruar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi arrin në përfundimin se kandidati Dedë Kasneci nuk plotëson kushtin e vjetërsisë në punë për të qenë kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, duke qenë se

ai ka më pak se 15 vite përvojë pune në pozicionet e kërkuara nga neni 125 i Kushtetutës dhe neni 7/a i ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese.

50. Këshilli konstaton se kandidati Dedë Kasneci ka një përvojë pune prej 14 vitesh për pozicionet e shpallur nga Presidenti i Republikës dhe 14 vitesh për atë të shpallur nga Kuvendi. Këshilli vlerëson se, në çdo rast, kjo vjetërsi është më e vogël se 15 vjet nga ajo e përcaktuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës, pa qenë e nevojshme të arsyetohet nëse duhet ti zbriten edhe 2 vjet e 1 muaj kur kandidati ka punuar si jurist/inspektor pranë Prefektit të Qarkut Shkodër.

51. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konstaton se kandidati llogarit si eksperiencë pune edhe periudhën prej tri vitesh e katër muajsh dhe gjithashtu edhe periudhën e qenies si pedagog i jashtëm në një shkollë jo publike të arsimit të lartë dhe ia shton këtë eksperiencë në mënyrë mekanike përvojës së mëparshme. Këshilli mban parasysh faktin se në vitet akademike kur kandidati ka qenë pedagog i jashtëm, njëkohësisht ka qenë i punësuar edhe në Kuvend dhe të dy përvojat e punës janë të mbivendosura në kohë.

52. Për rrjedhojë, Këshilli konkludon se ato nuk mund të qëndrojnë të pavarura nga njëra tjetra dhe të mblidhen mekanikisht në mënyrë që të përmbushin kushtin e vjetërsisë së kërkuar nga ligji. Këshilli vlerëson se, vetëm në rast se kandidati do të plotësonte përvojën dhe eksperiencën në punë prej 15 vitesh, periudha si pedagog i jashtëm do të merrej parasysh më vete vetëm për efekt të vlerësimit dhe të pikëzimit të kandidaturës, duke pasur parasysh vlerësimin e veprimtarisë së spikatur në fushën e së drejtës.

53. Këshilli konstaton se kandidati Dedë Kasneci nuk ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 237 të ligjit nr. 115/2016 ky kandidat gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për mospërmbushje të kushtit ligjor të veprimtarisë profesionale 15 vjeçare në njërin ose bashkërisht në ato të gjyqtarit, prokurorit, avokatit, lektorit të së drejtës, nëpunës (jurist) të nivelit të lartë në administratën publike.

54. Këshilli vlerëson të ritheksojë se kushtet e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për tu përzgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga organi i emërtesës. Në rast se kandidati nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetohet për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

55. Për këto arsye, duke ardhur në përfundimin se në lidhje me kandidatin Dedë Kasneci është i mjaftueshëm të vendoset ndalimi i kandidimit për motivin e mosplotësimit të kushtit ligjor të përcaktuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, Këshilli vlerëson se nuk është vendi për të vijuar me tej me analizë dhe arsyetim mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit.

56. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që

përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatit Dedë Kasneci në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “ *Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*” të pikës 3 të nenit 229 dhe të pikës 3 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të shkronjës “b” të pikës 50 dhe 96 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit Dedë Kasneci, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Dedë Kasneci.
3. Kandidati Dedë Kasneci ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

ARDIAN DVORANI

